





PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA



MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA

Për:	Menaxheret e Regjioneve
Përmes:	Januz Krasniqi, Drejtori i ATK-se 
Nga:	Sakip Imeri, Zv. Drejtor – Departamenti i Përmbushjes 
Data:	14.06.2007
Lënda:	Udhëzimi për trajtimin tatimor të OJQ-ve, me Statut të Përfitimit Publik

Të përgjithshme

Në Kosovë, ekziston Zyra e Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve që administrojnë regjistrimin dhe mbikëqyrjen e OJQ-ve. Njësia është pjesë e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Rregulloret për këtë fushë janë Rregullorja 1999/22 e UNMIK-ut dhe Udhëzimi Administrativ 2000/10 (i plotësuar në Udhëzimin Administrativ 2001/2).

OJQ-të e regjistruara me **Status të Përfitimit Publik (SPP)** janë të obliguara të bëjnë raporte vjetore në lidhje me veprimtarinë e tyre dhe aktivitetet në Kosovë që i zhvillojnë gjatë vitit. Raporti duhet të përbëhet prej tri pjesëve:

1. Pjesës së menaxhimit dhe administrimit;
2. Raportit mbi aktivitetet dhe të arriturat;
3. Pasqyrës financiare.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

OJQ-të me status të përfitimit publik normalisht nuk janë të obliguara ose nuk kanë të drejtë të regjistrohen për TVSH sepse nuk janë “*persona të tatueshëm*”. Për të qenë person i tatueshëm duhet të zhvillojë aktivitet ekonomik me qëllim të fitimit të të ardhurave (Rregullorja mbi TVSH-në Nr. 2002/17 Neni 1.7 dhe 1.25). Për shkak të kësaj këto OJQ nuk ngarkojnë me TVSH nëse dërgojnë jashtë faturat dhe nuk kanë të drejtë të rimburohen për TVSH-në që kanë paguar në blerjet e tyre. Deri në fund të vitit 2005 ka pasur mundësi që OJQ-të të rimburohen për TVSH-në e paguar në importe mirëpo kjo dispozitë është hequr, dhe ka hyrë në fuqi prej 1 Janarit 2006.

OJQ-të më **SPP** munden në deklaratat tatimore të tyre t’i ndajnë të ardhurat e tyre në ato që janë pranuar për qëllime të *Përfitimit Publik* dhe ato të cilat janë shfrytëzuar për qëllime të tjera. Kjo mund të shfrytëzohet vetëm nga tatimpaguesit të cilat janë pranuar nga Zyra e OJQ-ve se janë të lejuara të kanë të ardhura për qëllime të ndryshme. Librat dhe shënimet gjithashtu duhet të organizohen në përputhje me rrethanat, ashtu që të jetë e qartë çka është për qëllime të përfitimit publik dhe çka jo, dhe llojet e ndryshme të të ardhurave duhet të paraqiten ndaras në deklaratën tatimore.

Tatimi në burim në Paga

Vetëm organizatat që janë punëdhënës sipas rregullores së TAP janë të obliguara të bëjnë ndaljen në burim për tatim në paga. Neni 1(iv) i trajton edhe OJQ-të punëdhënës, kjo nënkupton se ata duhet të ndalin tatimin në burim për pagat e të punësuarve të tyre.

Kontributet pensionale

Baza ligjore për të paguar kontributet pensionale vjen nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 Mbi Pensionet në Kosovë (KP).

Obligimi për të paguar kontributet vjen nga Neni 7 i KP;

7.3 Punëdhënësi e zbrit kontributin e punonjësit nga rrogat e punonjësit dhe e bartë në llogarinë e posaçme të mbajtësit të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton administrata tatimore.

Mbajtja në burim për interes

Sipas nenit 27.1 të Rregullores 2004/51, të gjithë tatimpaguesit, sikur që është definuar në TAK dhe ku përfshihen edhe OJQ-të që bëjnë pagesa të interesit duhet të mbajnë tatimin prej 20% të secilës shumë të paguar ose të kredituar të interesit. OJQ-të janë tatimpagues sipas nenit 2c të TAK. OJQ-të janë të obliguara të ndalin tatimin në burim në interes.

Mbajtja e tatimit në qira.

Sipas nenit 27.2 të Rregullores 2004/51, tatimpaguesit duhet, sikur që është definuar në TAK dhe e cila përfshinë OJQ-të, të bëjnë pagesa të qirasë për persona të tjerë prej atyre fizik, duhet të mbajnë në burim 16 % të qirasë në kohën e pagesës ose të kreditojnë dhe dërgojnë tatimin e mbajtur në burim në Administratën Tatimore. OJQ-të janë tatimpagues sipas TAK, neni 2c.

Pra, OJQ-të janë të obliguara të ndalin tatimin në qira me rastin e pagesave që u bëjnë qiradhënësve të tyre.

Procedurat e kontrollit të tatimit.

Ligji nr.2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 12.1 rregullon se kush është obligues për krijimin dhe mbajtjen e shënimeve për qëllime të tatimit.

Personi i cili është obligues për të paguar ose mbajtur tatimin duhet të krijojë shënime të kontabilitetit në formë të shkruar ose në formë elektronike të cilat i përcaktojnë detyrimet e tyre për të paguar ose mbajtur në burim tatimin. Librat dhe shënimet specifike që kërkohen për tu përgatitur dhe mbajtur duhet të jenë ato të caktuara në legjislacionin relevant dhe në udhëzimet administrative. ATK-ja mund të kërkojë nga tatimpaguesi të bëhet përkthimi i shënimeve të cilat nuk janë të shkruara në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

OJQ-të më SPP janë të obliguara të paguajnë ose mbajnë në burim tatimin

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-ja) ka të drejtë sipas Ligjit 2004/48, neni 13.1 të ketë qasje në çdo lokal të biznesit ku zhvillohet biznesi, dhe ku gjenden librat, shënimet, kompjuterët dhe gjërat e ngjashme relevante për ndonjë obligim tatimor. Për më shumë detaje në Nenin 13 dhe 14.

Nga kjo mund të konkludohet se ATK ka të drejtë të kontrollojë OJQ-të me SPP, dhe këto organizata janë të obliguara të mundësojnë qasjen në vijë me këto dispozita.

Shpalosja e informatave.

Autorizimi i ATK-së për të përcaktuar (vlerësuar) OJQ-në që nuk operon përbrenda statusit të përfitimit publik:

ATK është institucion që ka mundësinë e kryerjes së kontrolleve dhe përcaktimit se OJQ është duke vepruar përbrenda statusit të përfitimit publik (SPP)

Çdo OJQ që ka ndonjë fitim ka gjasa të mos veprojë përbrenda SPP. (ATK beson se një OJQ ka të drejtë të ketë ca fitim përderisa ai fitim është përdorë për qëllime tjera të OJQ-së dhe nuk është shpërndarë që të përfitojnë drejtorët apo zyrtarët e OJQ-ve dhe nuk janë përdorë për të siguruar rroga tepër bujare për zyrtarët apo punëtorët e OJQ-së).

Dihet se zyrtaret e ATK-së gjithnjë i kontrollojnë deklaratat e viteve të kaluara të Tatimpaguesve. Këshilla dhe konsensusi është se nuk do të ishte e barabartë për ATK-ne të mohojë statusin SPP dhe të vlerësojë një detyrim tatimor për një entitet që ka besuar se nuk ka qenë i detyrueshëm për tatimin duke u bazuar në regjistrimin e vet si OJQ në regjistrin e OJQ-ve. Kështu, çdo ndryshim në statusin e pa tatueshëm të OJQ-së mund të jetë vetëm për periudhat pasi Administrata Tatimore ka bërë një përcaktim se OJQ nuk mund të mbajë statusin e vazhduar si një entitet i pa tatueshëm. Kjo nënkupton se një kontroll e një OJQ me SPP do të rezultojë në shpenzime të stafit pa pasur të hyra nga kontrollet.

Procesi në thelb do të përfshinte ATK-në në kryerjen e kontrolleve tek OJQ-të. Nëse ATK përcakton se OJQ nuk është duke vepruar në fushëveprimin e SPP, atëherë ATK do t'i lëshonte një njoftim OJQ-së me efekt, duke informuar OJQ-në se do të jetë e tatueshme në fitimet e saja nga data kurë është dorëzuar njoftimi. ATK do të dërgojë një kopje të këtij njoftimi në Zyrën e Regjistrimit të OJQ-ve. Njoftimi do të informonte OJQ-në për të drejtën e saj të ankohet për vendimin e ATK-se në zyrën e Regjistrimit të OJQ-ve, që do të ishte në gjendje të rishikojë përcaktimin dhe konfirmimin e vazhdimin të statusit të përfitimit publik të entitetit apo të përcaktonte se entiteti nuk ka më të drejtë në atë status. Njoftimi gjithashtu do të informonte tatimpaguesit mbi të drejtat e tyre të bëjnë ankesë përmes kanaleve normale të ankesave.

Këshilla e lartë përmendur nuk ka ndikim në udhëzimet në fuqi dhe në proceset që përfshijnë ankesat nga Tatimpaguesi, qoftë para Departamentit të Ankesave në ATK, ose para Bordit të Pavarur për Rishqyrtim.